

NEWSLETTER

2022

**Albsig Mundësoi
Lindjen e Një Nëne
të Re Ukrainase**

Albsig Med

Skema Shpërblimit e
Shoqërisë Albsig për
Klientët e Shëndetit

INTERVISTË FRYMËZUESE ME
Xhilda Liçaj

**Përtej Kufijve
të Zyrës me
Ëngjell Bakiu!**

 **ALBSIG**

PJESË E  KASTRATI GROUP

**Albsig, Pjesë e
Panairit të Punës**

**Raportimi i
Dëmit Online
Me Albsig**

2022

**Statistikat
e AMF**

Esmeralda Keta

GAZETARE E ÇËSHTJEVE SOCIALE

**“Për mua Albsig është bërë pjesë e
pandarë e udhëtimeve të përditshme.”**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





PJESË E  KASTRATI GROUP





Albsig MED

Karta MED, Një Skemë Shpërblimi e Shoqërisë Albsig për Klientët e Shëndetit

Albsig, Shoqëria e Sigurimeve me trendin më të madh të rritjeve në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ka marrë një vëmendje të madhe brenda dhe jashtë vendit. Kjo jo vetëm për shkak të qëndrueshmërisë në treg dhe rritjes së vazhdueshme të paktën pesë vitet e fundit, por edhe në sajë të specialistëve dhe punonjësve më me emër, përmes të cilëve mbulohet një gamë e madhe produktesh në industrinë e sigurimeve. Ajo që Albsig zbaton me korrektësi është ofrimi i një game produktesh dhe shërbimesh cilësore me çmimin më të mirë në treg. Aktualisht shoqëria ka hedhur në treg Karten MED, një skemë shpërblimi e Albsig për klientët e Shëndetit dhe jo vetëm. Klientët e Albsig gëzojnë një trajtim të veçantë. Ata trajtohen nga punonjësit me një kujdes të veçantë, derisa në shërbimet e tyre i kryejmë me efikasitet dhe përgjegjësi të lartë. Ndërkohë në anën tjetër, klientët në çdo kohë mund të ankohen për çdo shërbim nëse nuk ka qenë në nivel dhe çdo lëshim eventual i mundshëm i policave të sigurimit. Gjithsesi ankesa e tyre trajtohet me shumë kujdes kur merret parasysh motoja e Albsig që klienti çdo herë ka të drejtë. Vlen të theksohet fakti se Kompania e Sigurimeve Albsig ka menduar edhe për klientët e saj që nuk kanë kohë të vijnë në zyrat e shitjeve duke ju mundësuar atyre pyetësorët e sigurimeve të ndryshme që mund t'i plotësojnë online përmes faqës sonë të internetit www.albsig.al, ku aty mund të gjejnë edhe informacione të ndryshme rreth

sigurimeve që u interesojnë gjithashtu dhe mund të blejnë online produktet që ju nevojiten.

MED-Kartë, Mundësi Lehtësuese për Shëndetin

Për të shpërblyer të gjithë klientët e saj, Albsig ofron Kartën e Shëndetit MED, e cila përveç lehtësirave të shumta bën të mundur dhe ofrimin e menjëhershëm të përgjigjeve online të çdo procesi. Jo vetëm kaq, por ata që do të pajisen me këtë kartë ju jep mundësinë të kursejnë nga 20-30% zbritje në analizat dhe vizitat mjekësore dhe njëkohësisht dhe 10% ulje në ndërhyrjet kirurgjikale. Duke qenë të pajisur me kartën MED, ju përfitoni edhe nga promocionet e Albsig, si edhe nga oferta të shumta gjatë gjithë vitit.

Si Mund të Pajiseni me Kartën MED?

Pajisja me Kartën MED është shumë e thjeshtë, mjafton të plotësoni formularin online ose të paraqiteni në një nga zyrat e shitjeve të Albsig dhe brenda një kohe shumë të shkurtër, do të pajiseni me Kartën MED. Për Kartën MED nuk duhen procedura dhe dokumenta. Mjafton që klienti të shkojë me kartën e identitetit pranë zyrave të shitjes së Albsig dhe menjëherë do të pajiset me kartë. Karta MED do të jetë çelësi i mundësive për klientët e Shëndetit dhe jo vetëm, të cilët do të kenë mundësi dhe akses të jenë prezent në të gjithë rrjetin spitalor ku ata duan dhe ndjehen komod.

Çmimi Konkurrues dhe Favorizues për Klientët

Korrektësia e ALBSIG dhe dëmshpërblimet në kohë rekord, janë shpërblyer me besim të klientëve dhe bizneseve ndaj shoqërisë. Mungesa e kulturës së sigurimeve ka bërë që kërkesa për produkte siguri lidhur me sigurimin e shëndetit, mbetet tepër e ulët në Shqipëri. Menjëherë pas pandemisë është parë një kërkesë në rritje e klientëve individë, më së shumti për sigurimin e shëndetit, kërkesë e cila u mbështet me paketat individuale e familjare shumë konkurruese dhe me çmime favorizuese. Një ndër to është Karta MED e dizenuar në mënyrë të tillë që të jetë në xhepin e çdo shqiptari. Ajo kushton vetëm 10 Euro dhe favorizon çdo qytetar që të pajiset me të.

Vlefshmëria

Parandalimi është më i mirë se kurimi. Është kjo shprehja që na përndjek kudo përsa i përket mbrojtjes së shëndetit. Mjafton të pajisesh me Kartën MED dhe për një periudhë 1-vjeçare do të jesh i sigurt dhe komod për çdo të papritur që mund t'ju ndodhë ju ose familjarëve tuaj. Duke blerë Kartën e Shëndetit MED në Albsig, për vetëm 10 Euro, për 1 vit ju bëheni mbartës i një sërë privilegjesh, duke filluar që nga konsulta mjekësore falas, zbritje në një sërë ekzaminimesh mjekësore dhe çmime preferenciale.

Albsig Mundësoi Lindjen e Një Nëne të Re Ukrainase, Pranë Spitalit Hygeia në Tiranë.



Asaj i duket tashmë si një ëndërr, i duket gjithçka që ka kaluar si frekuencat e një filmi, por që i ka rilindur shpresat e së ardhmes pasi kaloi kufijtë e atdheut të saj të lënë mes gërmadhve të luftës. E reja ukrainase shtatëzëne i shpëtoi luftës e vetme pa bashkëshortin e saj. Bëhet fjalë për një 28-vjeçare ukrainase, e cila ka pak ditë që ka ardhur në Shqipëri. Ajo ka ardhur pa bashkëshortin e saj, por nuk ndihet vetëm dhe e pa mbrojtur. Tashmë zoti e ka bekuar me një ëngjëll të vogël që i ka ndryshuar jetën. Miroslav është ukrainasi i sapolindur në Tiranë. Procesi i lindjes së Miroslav-it është sponsorizuar nga Shoqëria e Sigurimeve Albsig pranë Spitalit Hygeia. Vetëm falë Albsig, ukrainases së re i janë plotësuar të gjitha kushtet për të patur një lindje të mbarë dhe pa probleme shëndetësore si për të dhe për të voglin e saj të porsalindur. Ajo është mirënjohëse ndaj gjithësecilit që e ka ndihmuar për ta transportuar nga Ukraina në Shqipëri dhe gjithashtu nuk le pa falenderuar dhe Shoqërinë Albsig, e cila ishte mbështetëse e saj në momentin më të rëndësishëm të jetës së saj siç ishte ardhja në jetë e Miroslav. E reja fjalëpakë e me shumë mirënjohje tregon se bashkëshorti i saj është pjesë e ushtrisë së Ukrainës. Mes lotësh ajo tregon se bashkëshorti i saj është vënë në dijeni për ardhjen në jetë të djalit të sapolindur.

“Falenderoj Shoqërinë Albsig, e cila ishte mbështetëse në momentin më të rëndësishëm të jetës sime.”

— nëna e Miroslav

Dhe jo vetëm kaq, por mes lotësh ajo thotë se përmes kamerave të telefonit i ati i Miroslav e ka parë të voglin për herë të parë. Ajo shpreson shumë që shumë shpejt do mund të ketë mundësi të mbarojë lufta dhe të bashkohet me bashkëshortin e saj dhe së bashku me Miroslav të kenë një jetë të qetë. Miroslav është fëmija i pestë i lindur në Shqipëri nga nënat ukrainase të deklaruara deri tani në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri nga mesi i muajit Mars deri tani kanë mbërritur më shumë se 300 ukrainas, të cilët kanë filluar të përshtaten me jetesën këtu. Bledi Bajraktari -Konsulli i Nderit të Ukrainës, gjatë një emisioni televiziv tha se në Shqipëri kanë lindur fëmijët e parë të grave ukrainase, të cilat i kanë shpëtuar luftës në Ukrainë. “Kushdo që ka ardhur në mënyrë individuale dhe ne nuk e dimë do u thoja të lenë kontaktet në Ambasadën e Ukrainës dhe t’u vijmë në ndihmë. Një pjesë e kanë përdorur mbërritjen për të ikur në Shqipëri. Është rritur numri me dhjetëra. Kemi dhe të lindurit e parë. Një vajzë refugjate para dy ditësh solli në jetë djalë e saj,” u shpreh Bajraktari. Më tej Konsulli tregoi se ukrainasit kanë filluar edhe kërkesat e para për të marrë statusin e azilantit në vendin tonë. “Kemi edhe kërkesa për azil në vendin tonë. Janë disa procedura ligjore që do të ndiqen dhe janë procedura burokratike dhe nuk kemi hasur probleme. Disa janë përshtetur,” tregoi Konsulli. Ai falenderon çdo biznes e sipërmarrje që bën të mundur ndihmesën e shtetasve ukrainas në Tiranë. Gjithashtu bën thirrje gjithkujt që sipas mundësive që ata kanë të kontribuojnë me ndihma për shtetasit ukrainas që janë në luftë. Deri tani janë mirënjohes për gjithësecilin qytetar e biznes që ka kontribuar pranë tendave të ngritura pranë Bashkisë së Tiranës për mbledhjen e ndihmave për Ukrainën.



**“Për mua
Albsig është
bërë pjesë e
pandarë e
udhëtimeve të
përditshme.”**

Esmeralda Keta

Gazetare e Çështjeve Sociale në Top-Channel

Esmeralda Keta është gazetare e çështjeve sociale në Top-Channel. Ajo është fituese e dy çmimeve nga BE. Është një ndër gazetaret më të mira të problematikave sociale dhe spikat me çështjet që ajo trajton. Duke qenë gazetare investiguese ajo tashmë është e përfshirë në të gjitha hallkat jetësore të përditshmërisë. Përsa i përket sigurimeve ajo është treguar shume e kujdesshme ndaj financave të familjes.

Numëron 10 vite si kliente e Albsig dhe këtë marrëdhënie të nisur si rastësore, tashmë e vlerëson shumë. “Për mua Albsig është bërë pjesë e pandarë e udhëtimeve tona të përditshme. Ishte rastësi prej 10 vitesh, kur zgjodha për herë të parë t’i besoj siguracionin e makinës Albsig dhe që atëherë, jo vetëm që nuk e ndërroj më, por ua rekomandoj të gjithëve.”, u shpreh Keta. Ajo shton se prej kaq vitesh Albsig është bashkëudhëtar, jo vetëm për automjetin e saj, por edhe në udhëtimet që ajo ka bërë brenda dhe jashtë vendit. “Kam marr një shërbim cilësor dhe në kohë rekord edhe online. Numërohen me dhjetra udhëtime, jo vetëm pune, por edhe pushime familjare që kam pasur si bashkudhëtar dhe Albsig. Duke qenë se vetë kam mbetur e kënaqur prej vitesh pranë Albsig, kam sugjeruar dhe kanë siguruar automjetet, shëndetin, shtëpitë edhe familjarët e mi. Shpejtësi, siguri dhe përgjigje në kohë reale kam hasur vetëm në Albsig. Besojini atyre që e kanë provuar jo vetëm produktet, por dhe shërbimet e Albsig.

Nese doni të jeni të sigurt, atëherë zgjidhni Albsig”, vijon Keta. Sipas saj edhe pse deri tani ka munguar edukata mbi sigurimet në Shqipëri, vitet e fundit pas tërmetit dhe pandemisë duket që konsumatorët janë ndërgjegjësuar. “Sigurimi i shëndetit, shtëpisë dhe automjetit është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për gjithësecilin prej nesh, por edhe për financat e çdo familjeje shqiptare. Duhet që edhe fëmijet tanë tashmë të mësohen mbi edukatën, mbi sigurimet dhe këtë edukim e shohim me së shumti përmes Albsig. Për çdo ndryshim oferte apo produkte të reja Albsig na njofton”, përfundon gazetarja.

Raporto Dëmin Motorik TPL Online

**Kurse Kohën
Evito Burokracitë
Zgjidh Punë**





Xhilda Liçaj

**Specialiste Finance, pranë Drejtorisë
së Sigurimit Kasko dhe GPS.**



Tani po shkon drejt të 28-tave dhe është familjarizuar mjaft mirë me punën në Albsig. Është e përkushtuar pas financës. Singeriteti, përpikmëria dhe korrektësia e shoqërojnë, jo vetëm brenda ambienteve të punës, por dhe jashtë saj. Shquhet për përkushtimin e saj në punë dhe për korrektësinë për të çuar deri në fund çdo procedurë financiar që asaj i kërkohet. Bëhet fjalë për Xhilda Liçaj, Specialiste Finance, pranë Drejtorisë së Sigurimit Kasko dhe GPS.

Kur keni filluar punë si financiere?

Unë kam qenë që fëmijë çapkëne. E kam dashur punën që e vogël. Edhe gjatë viteve të gjimnazit unë jam aktivizuar me punë në sezonin e pushimeve. Por punën tamam të pashkëputur e kam filluar në vit të fundit të fakultetit. Atëherë une isha edhe në punë edhe në shkollë. Bëja paralel dhe punën dhe shkollën dhe isha shumë e kënaqur sepse po mësoja zanatin. Në Albsig erdha pas një përvojë pune që kisha marrë si financiere pranë një restoranti të njohur në Tiranë.

Po në Albsig sa vite pune keni?

Jam krenare dhe falenderuese që Albsig më dha mundësin që prej 5 vitesh të jem pjesë e këtij stafi të mrekullueshëm. Jam shumë falenderuese sepse më dhanë mundësinë të rritem e të mësoj pranë kësaj familje të madhe. Kam prej më shumë se 3 vitesh që punoj pranë Drejtorisë së Sigurimit Kasko dhe GPS dhe jam e frymëzuar dhe shumë optimiste për të ardhmen. E shikoj veten shumë të përfshirë në fushën që përfaqësoj dhe punoj me përkushtim dhe këmbëngulje që të jem e denjë për pozicionin që më është besuar.

Si nisi rrugëtimi juaj pranë Albsig?

Siç edhe jua përmenda pak më lart unë kur erdha në Albsig nuk është se isha pa përvojë fare në fushën e financave. Por tregu i sigurimeve ka specifikat e veta dhe mu desh të mësoja të gjitha procedurat që duheshin në fillim si specialist shitjesh në Drejtorinë e Përgjithshme të Albsig. Takimi ballë për ballë me klientët më bëri që unë të mësoj çdo gjë rreth produkteve dhe shërbimeve që Albsig ka. Më pas kalova në pjesën e administrimit të policave të sigurimit ku qëndrova për një kohë relativisht të konsiderueshme dhe mësova shumë prej saj.

Sa e shikon veten të lidhur me fushën e sigurimeve, me Albsig?

Duke u ndjerë çdo ditë e vlerësuar për punën që bëj dhe duke u motivuar çdo ditë për të dhënë më të mirën unë e ndiej veten shumë të lidhur me Albsig. Jo vetëm kaq, por motivimi në punë më bën që unë të eci sa më shumë para në këtë fushë. Drejtoria e Sigurimit KASKO dhe GPS, është një ndër më të veçantat edhe persa i përket produkteve dhe shërbimeve që ne kemi, por dhe për stafin profesionist dhe shumë të kualifikuar

Duke qenë se ju jeni në Drejtorinë e Sigurimit Kasko dhe GPS, a haseni me problematika gjatë ditës?

Probleme të zgjidhshme hasim pothuajse çdo ditë. Ajo që unë gjithmonë praktikoj është se së pari do të vlerësoja situatën, duke u siguruar që kam të drejtë në gjykimin tim për problematikën që më paraqitet. Pastaj, unë do të ndiqja çdo protokoll të brendshëm për trajtimin e situatës, të tilla si kontaktimi i shefit tim drejtpërdrejt, para se ta vazhdoja më tej. Unë si person respektoj në mënyrë rigoroz hierarkinë e kompanisë dhe jam e kënaqur sepse për çdo paqartësi apo problem gjendet zgjidhja e menjëhershme sipas standardeve të duhura.

Ku e shikon veten pas 5-vitesh?

Unë kam qenë me fat që jam pjesë e Shoqërisë së Sigurimeve Albsig dhe për këtë i jam përkushtuar me pasion profesionit tim si financiere dhe veten edhe për këtë periudhë e shikoj në Albsig. Falë drejtuesve të kompanisë çdo i punësuar në Albsig është i mbështetur me të gjitha standardet e duhura që i takojnë çdo punonjësi. Gjithësecili prej nesh trajnuar në fushat përkatëse duke nxjerrë në pah dhuntinë e gjithësecilit. Përderisa jam e motivuar në punë shikoj vetem para dhe mendoj se çdo ëndërr e gjithësecilit prej nesh do të realizohet.

Mendon se femrat janë më të prirura për financa?

Fusha e financës kërkon më tepër përqëndrim, korrektësi dhe normalisht aftësi të mira profesionale. Keto veti nuk mund t'i kenë vetëm femrat, por duke qenë punë zyre është e natyrshme që femrat të përshtaten më me lehtësi.

Cila është arma më e fortë e femrave në jetë?

Femra shpesh shihet për sharm, herë si modele apo balerinë, por arma më e fortë e femrës në jetë është butësia dhe zgjuarsia. Megjithatë mund të them se

“Askush nuk është aq i pasur sa të mos i nevojitet një buzëqeshje dhe askush nuk është aq i varfër sa buzëqeshja të mos e pasuronte.”

E kush më mirë se ne femrat mund ta personifikojmë të gjithë këtë.



Ëngjell Bakiu

Manaxher i Shitjeve në Albsig ose ndryshe guida e çdo natyrëdashësi.

Duam të punojmë, por edhe të bëjmë sport! Të udhëtojmë afër dhe larg, t'i ngjitemi majave, por të zbulojmë dhe shpellat nga ku buron uji i maleve... Të thithim ajër të pastër, por të provojmë dhe hajet e pijet e freskëta! Të bëjmë not, por edhe vrapime! Të shëtisim me biçikleta, të rrezitemi, por edhe të lexojmë! Të gjitha dëshirat e mësipërme përmbushen për çdo fundjavë nga Ëngjell Bakiu, Manaxher i Shitjeve në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig.

“Bëhen 6 vite pranë Albsig dhe janë nga vitet më të bukura të karrierës sime në Departamentin e Shitjes”, kështu nis të tregojë për përvojën e tij përtej Albsig-ut, Ëngjell Bakiu, Manaxher Shitjesh në Departamentin e Sigurimit Kasko në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig.

Në dukje është fjalëpakë e punë shumë. Është shumë strikt dhe korrekt në pozicionin e punës që ja ka besuar Albsig. Të njëjtën sjellje e pasqyron dhe jashtë kufijve të zyrës së punës. Është ndër të vetmit punonjës që ka eksploruar natyrën me pellëmbë në çdo cep të Shqipërisë dhe jo vetëm. Hiking është patjetër një përvojë mahnitëse, e cila shndërrohet në një sfidë të vërtetë për menaxherin e Albsigut.

Prandaj hiking për këtë të fundit nuk mund të konsiderohet si sport, por si një domosdoshmëri për të ruajtur balancat e jetës, pasi balancat e jetës ruhen kur jemi në lëvizje. Dëshira për të eksploruar dhe rendja pas aventurës në natyrë i ka ardhur si domosdoshmëri gjatë 15 viteve në procesin e shitjes, edhe pse në fillimet e saj ishte e pa strukturuar si pasion. Tani mesa shikohet pasioni për natyrën dalëngadalë po i kthehet dhe në një profesion të dytë. Ndërsa tani nuk mund të thotë të njëjtën gjë në këto momente pasi i është bërë pjesë e jetës dhe eksplorimi në male dhe në natyrë është një përmbushje që nuk ia ofron asgjë tjetër.

”

Përtej Kufijve të Zyrës!

“Shkëputja nga civilizimi dhe rikthimi sërish, është kombinimi perfekt dhe nuk është luks, por nevojë”, e thekson Bakiu. Ai shton se duke eksploruar çdo natyrë vlerëson dhe atraksionet që të ofron vendi yt. Numëron me dhjetra takime me barinj të në stane në lartësi mbi 2000 m.

Kujton me nostalgji bisedat me ta dhe prek më nga afër dhe jetesën e tyre. Kujton aventurat e ndryshme të ndodhura në malet e pa eksploruara dhe tregon me nostalgji se si kanë humbur shtegun gjatë natës dhe në mëngjes kanë gjetur një luginë të mrekullueshme. Çdo gjë duket se ja ka vlejtur për mundimin e ngjitjes, frikën dhe ankthin që ka përjetuar.

“Pas një fundjave me oksigjenim dhe energji të shpenzuara nga mundimi dhe jo nga pasiviteti, e ndien që je rikthyer në procesin normal të jetës ku të merr uria dhe etja është gjithmonë në momentin e duhur. Kështu jam gati për t’u rikthyer në punën e zyrës. Kolegë dhe drejtues profesionistë që të mbajnë të motivuar gjatë gjithë javës dhe të zbukurojnë idetë dhe je i lirë të mendosh për aventurën e radhës. Të nisësh për aventurë është e pëlqyeshme, rikthimi është i detyrueshëm” përfundon së treguari Bakiu.

**“Be happy for this moment.
This moment is your life”**



Albsig, Pjesë e Panairit të Punës ku Morën Pjesë 30 Kompani Biznesi për 800 Vende Pune

Panairi i Punës, i zhvilluar para pak ditësh në Tiranë, tërhoqi interes jo vetëm nga punëkërkuar, por edhe të rinj të interesuar për trajnime profesionale. I konsideruar si një nga aktivitetet më të rëndësishme në fushën e tregut të punës, panairi bëri bashkë biznesin, punëkërkuar, institucionet publike dhe private që ofrojnë shërbime punësimi dhe institucionet e Arsimit dhe Formimit Profesional që përgatisin profesionistë të kërkuar në tregun e sotëm të punës. Në panair morën pjesë 30 kompani biznesi më në zë ku pjesë e tyre është dhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, e cila hapi siparin e saj për rekrutimin e punëkërkuar dhe të rinjve të interesuar në këtë event. Panairi i këtij viti duket se ka në fokus krijimin e një sinergjie në tregun shqiptar të punës, sidomos në komunikimin midis punëkërkuar dhe punëdhënësit. "Shoqëria Albsig prej dy ditësh ka hapur dyert për të mirëpritur

kandidaturat e ndryshme të të rinjve dhe punëkërkuarve për t'u bërë pjesë e kësaj shoqërie të madhe", kështu është shprehur në panair Drejtoresha e Marketingut të Albsig, Valbona Dako. Sipas saj numri i personave që e kanë vizituar stendën e Albsig dhe që kanë aplikuar për punë në këtë panair është i madh, duke i kaluar edhe pritshmëritë. Dy ditë janë dedikuar punësimit dhe aftësisimit profesional të të rinjve dhe punëkërkuarve nga stafi i Albsig. Ky panair vjen si një nismë ku bëhen bashkë Bashkia e Tiranës me Ambasadën Greke në Tiranë dhe Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri. Albsig ka suportuar gjithmonë, jo vetëm punëkërkuar, por dhe të rinjtë sidomos studentët e universiteteve private dhe shtetërore duke u bërë pjesë e një sërë panairesh dhe work-shop-esh. Albsig është dhe do të jetë gjithmonë përkrahëse e të rinjve për t'ju dhënë atyre mundësinë e punësimit.


Panairi Punës 2022





Statistikat e AMF. (Muaji Janar-Shkurt)

Sipas të dhënave statistikore të AMF-së për muajt Janar - Shkurt 2022, Albsig renditet e para në disa grupe produktesh:



Jemi krenarë që edhe në këtë periudhë të vështirë për të gjithë tregun, Albsig ka rritjen më të madhe me veten me 16.91%, ndërkohë që tregu ka një rënie prej -1.84%.



Dëmet Pezull (sipas AMF)

Një skuadër profesioniste dhe e palodhur qëndron gjithmonë pas Departamentit të Dëmeve në Shoqërinë Albsig. Është e vetmja shoqëri që spikat nje korrektësi në marrëdhëniet me dëmet. Jo vetëm kaq, por kjo e fundit është cilësuar si e vetmja shoqëri që ka mbyllur në kohë rekord dhe kundrejt procedurave të duhura të gjitha dosjet e dëmeve të tërmetit.

Ndryshe nga shoqëritë e tjera për periudhat Janar-Shkurt të vitit 2022 Albsig është Shoqëria e Sigurimeve që ka numrin më të ulët të dëmeve pezull në të gjithë tregun dhe ka uljen më të madhe 36.22% me veten e saj. Persa i përket numrit të dëmeve pezull krahasuar nga viti 28.02.2021 që ishte me 317 dëme në 28.02.2022 duke shkuar në 279 dëme.

Pra këtë vit janë në numër më pak se 38 dosje dhe në vlerë 36,22% çfarë e evidenton që Albsig paguan në kohë rekord të gjitha llojet e dëmeve.

Vlerat që na bashkojnë.





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL